# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-435698**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Zjarret në vend/ 30 vatra gjatë ditës, 7 mbeten aktive! Mbi 400 forca në terren |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/zjarret-ne-vend-30-vatra-gjate-dites-7-mbeten-aktive-mbi-400-forca-ne-te-i585271` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 19:08:47 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 19:45:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `69de3bde36714dd21234c8863e69b1921b3948923ba65be292beef9c7e56191e` |
| TEKSTI | `1b96f9d9e7b12ac979125f39d0a799a91980688fbd7a2ecba9ac8ca5fe33e0f0` |
| PAMJA | `222aa84782dfd0fce9cf2cdfb0cd40501ac0c1f408a8f27382cbc9c197fa7291` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `bf0551c8417e3159f1653931a2dea257522f586e7cafe2e74848fbdd51dc7006` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/bf0551c8417e3159f1653931a2dea257522f586e7cafe2e74848fbdd51dc7006`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Zjarret në vend/ 30 vatra gjatë ditës, 7 mbeten aktive! Mbi 400 forca në terren

10 Shtator 2026, 21:45Kronika TEMA

Zjarret në vend/ 30 vatra gjatë ditës, 7 mbeten aktive! Mbi 400

Ministria e Mbrojtjes së fundmi ka dalë me një përditësim mbi situatën e zjarreve në vend. Në njoftimin e ministrisë mësohet se gjatë ditës së sotme janë raportuar 30 vatra zjarri, prej të cilave 7 mbeten aktive. Më tej bëhet me dije se 10 janë nën mbikëqyrje dhe 13 janë shuar plotësisht.

Në operacione janë angazhuar 404 forca operacionale vendore dhe lokale dhe 21 automjete zjarrfikëse. Forcat e Armatosura kanë mbështetur operacionet me 133 efektivë, 1 helikopter, 2 automjete zjarrfikëse, 1 dron, 13 mjete dhe 1 autoambulancë.

Në Qarkun Tiranë, vijon aktive vatra në Malin e Dajtit, ku gjatë ditës kanë operuar 25 zjarrfikës, 7 forca të ADZM-së, si dhe 52 efektivë të FA me 6 mjete dhe 1 autoambulancë. Nuk ka rrezik për zonat e banuara. Vatrat në Malin e Bërzhitës dhe Mali me Gropa janë izoluar dhe mbahen nën mbikëqyrje.

Në Qarkun Dibër mbeten aktive disa vatra: në Lundre–Madhesh, Mat, në Cerrujë–Mali i Allushit, Klos, në Selishtë, si dhe vatra e re në Pleshë, Klos. Vatra në Qafën e Helmes mbahet nën mbikëqyrje.

Në Qarkun Shkodër, aktive mbetet vatra në Porav, Fushë-Arrëz, ndërsa zjarret në Rragam dhe në malin e Tërbunit janë nën mbikëqyrje dhe nuk paraqesin rrezik për zonat e banuara. Vatra në Mnelë të Madhe është shuar.

Në Qarkun Fier, vatra në Peshtan mbahet nën monitorim, ndërsa zjarri në Çërrilë, Mallakastër, vijon aktiv. Për këtë vatër janë angazhuar forcat vendore, pyjore dhe të mbrojtjes civile, ndërsa FA kanë ndërhyrë me 1 helikopter, 32 efektivë dhe 3 mjete.

Në qarqet Lezhë, Elbasan dhe Korçë, situata paraqitet më e qëndrueshme: vatrat e raportuara janë kryesisht të shuara ose nën mbikëqyrje. Në Opar, Korçë, vijon puna në terren, por vatra klasifikohet nën mbikëqyrje dhe nuk rrezikohen banesa.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) vijon të ndjekë në mënyrë të pandërprerë situatën në të gjithë territorin e vendit, në koordinim të ngushtë me prefekturat, bashkitë dhe të gjitha strukturat e sistemit të Mbrojtjes Civile.

Kapacitetet operacionale mbeten të angazhuara në terren dhe në gatishmëri për të ndërhyrë aty ku situata e kërkon, me prioritet mbrojtjen e jetës, banesave, pasurisë së qytetarëve dhe mjedisit.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Aksident në aksin Lushnjë-Berat, përplasen tre automjete, dy të plagosur rëndë

18:05 Kronika

Ekzekutimi mafioz i 35-vjeçarit shqiptar në Itali, Ferdinant Hoti kishte tentuar të largohej nga bota e trafikut të drogës

17:25 Kronika

VIDEO/ Policia bllokon "Rolls-Royce"-in 200 mijë paund në Lezhë, nis hetimi pasuror për pronarin

17:15 Kronika / 1 koment

Gjyqtarë, para dhe politikë - Avokati: Padia në SPAK, e rrezikshme. Gjyqësori po bëhet palë me opozitën

15:55 Kronika / 7 komente

Çmontohet organizata e mashtrimeve kompjuterike, 11 të akuzuar! SPAK zbulon skemën nga Gjermania në Tiranë, burg për shqiptarët

14:15 Kronika / 1 koment

Rregullorja e re kufizon mediat/ GjKKO nuk tërhiqet, mbyll grupin në Whatsapp të gazetarëve që nuk u akredituan

13:45 Kronika / 1 koment

"Helsinki" letër Burgut 313: Jepini fund shkeljes së të drejtave të ish-presidentit Meta

13:35 Kronika / 22 komente

Bllokuan rrugët dhe u përplasën me policinë, 1 i arrestuar dhe 15 nën procedim pas protestës

12:43 Kronika / 4 komente

Projektligji i ri në Kuvend - Subjektet me ndërtime pa leje 6 muaj kohë për vetëdeklarim. Shteti merr përsipër pallatet e lëna përgjysmë

12:05 Kronika / 1 koment

Pagat e magjistratëve, shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve kallëzojnë Ministrinë e Financave në SPAK

11:48 Kronika / 15 komente

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 16 komente

**VIDEO/ Protestuesit nuk kursejnë as qytetarët, sulmojnë n...**

21:12 Politika / 80 komente

**Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 16 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 46 komente

**Përçarja në protestë, Balla i përshëndet nga Paskuqani pa...**

22:10 Politika / 3 komente

## Blog Tema

**Një telash më shumë për Partinë Demokratike**

19:10 Blog / 2 komente

**Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin**

18:28 Blog / 5 komente

**Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë**

17:05 Blog / 6 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by


- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies


Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.